

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Shoqatën "Për Një Shqipëri të Shëndetshme", zhvilluan një leksion të hapur me studentët e Infermierisë. Tema e këtij leksioni ishte: "Ethet dhe Sëmundjet Konvulsive në moshat Pediatrike".

Qëllimi i këtij leksioni ishte të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohuritë profesionale të studentëve mbi diagnostikimin, menaxhimin dhe ndërhyrjet infermierore në rastet e sëmundjeve konvulsive te fëmijët.

Gjithashtu, u synua përmirësimi i aftësive praktike dhe teorike të studentëve në përballjen me situata të ngjashme gjatë praktikës së tyre mjekësore.

